

Një miliard euro për Kosovën po presin një "po" nga deputetët


FAQE 3



120 DEPUTETËT E LEGJISLATURËS SË RE TË KUVENDIT TË KOSOVËS

FAQE 4-5

NDARJA E VENDEVE



Lëvizja VETËVENDOSJEJ 57	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK 22	LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK 15	SRPSKA LISTA 9	AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS 6
KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KDTP 2	Za Slobodu Pravdu i Opstanak 1	KOALICIJA VAKAT 1	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA 1	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS 1
SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA - SDU 1	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE 1	PSA 1	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA 1	Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës 1

Të premten ka përfunduar numërimi i pjesës së fundit të fletëvotimeve nga votimi me postë jashtë Kosovës, duke shënuar kështu përfundimin e procesit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga zgjedhjet e 28 dhjetorit. Tashmë KQZ-ja është e gatshme për ta shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme të mbajtura më 28 dhjetor por, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, palët mund të parashtrojnë ndonjë ankesë në PZAP lidhur me administrimin e numërimit në QNR brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar

PËRFUNDON NUMËRIMI I TË GJITHA VOTAVE PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

F. 3



HAMZA: RUAJTJA E VOTËS SONË ËSHTË DËSHMI SE MIJËRA QYTETARË BESOJNË NË VLERAT E PDK-së

F. 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

OPOZITA NË VDEKJE KLINIKE! F. 6

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA



AKTUALE



STUHIA GORETTI GODET EVROPËN, QINDRA MIJËRA FAMILJE MBESIN PA RRYMË F. 2

ÇAKOLLI: GJASAT PËR ZGJEDHJE JANË REALE, MUND TË MBAHEN NË JAVËN E DYTË TË PRILLIT F. 5

EKONOMI



OEK-u DHE AKB-ja: ZJARRI NË 'COMODITA', HUMBJE E MADHE PËR EKONOMINË F. 8

LLUGALIU: VITI 2025 KONFIRMOI REKORDE TË REJA PËR DOGANËN E KOSOVËS F. 8

SPORT

AMIR RRAHMANI NOMINOHET PËR "EA SPORTS FC 26 TEAM OF THE YEAR" F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

STUHIA GORETTI GODET EVROPËN, QINDRA MIJËRA FAMILJE MBESIN PA RRYMË

PARIS, 9 JANAR - Erërat e fuqishme goditën Francën dhe Britaninë të premtën, ndërsa stuhia Goretti mbërtheu Evropën Veriore, duke lënë pa energji elektrike qindra mijëra familje.

Meteorologët nga Britania deri në Gjermani u bënë thirrje qytetarëve që të qëndrojnë brenda, ndërsa lëshuan paralajmërime për motin e keq, përfshirë edhe alarmin e kuq për erëra - niveli më i lartë i rrezikut që rrallë lëshohet - për ishujt Skilli dhe Kornuall në jugperëndim të Anglisë.

Në Francë afër 380 000 familje mbetën pa rrymë, shumica në rajonin verior të Normandisë, bëri me dije kompania e shpërndarjes së energjisë Enedis, ndërsa BBC-ja raportoi se rreth 65 000 familje kanë mbetur pa rrymë.

Gjatë natës në rajonin veriperëndimor francez Mançe u regjistruan erëra nga 216 dhe 213 kilometra në orë, thanë autoritetet.

Stuhia ka bërë që të rrëzohen pemë në disa rajone dhe në të

paktën një rast, një pemë ra mbi një ndërtesë banimi, por nuk pati të lënduar, thanë autoritetet në Francë.

Në disa pjesë të Britanisë priten erëra deri në 160 kilometra në orë dhe “valë shumë të mëdha do të krijojnë kushte të rrezikshme në zonat bregdetare”, tha Shërbimi Meteorologjik i Britanisë.

Ky shërbim lëshoi një alarm portokalli për reshje bore në Uells, Anglinë Qendrore dhe pjesët veriore të Anglisë, duke parashikuar deri në 30 centimetra borë në disa zona.

Shërbimi hekurudhor britanik ka njoftuar se trafiku i trenave do të ndikohet gjatë dy ditëve të ardhshme dhe u ka bërë thirrje qytetarëve t’i shmangin udhëtimet, përveç në rastet e domosdoshme.

Shkollat vazhdojnë të jenë të mbyllura në veri të Francës, ku janë lëshuar paralajmërime për motin e keq në 30 rajone të tjera. “Strehohuni dhe mos përdorni automjetet thuaja”, thanë autoritetet në Mançe të enjten, duke u bërë thirrje



banorëve të përgatisin furnizime të ujit dhe të sigurojnë llamba ndriçuese.

Kushtet aktuale ekstreme të motit në Evropë kanë shkaktuar të paktën tetë viktima, dhe të enjten policia në Durrës të Shqipërisë nxori trupin e një burri nga ujërat pas përmbytjeve, disa ditë pas shirave të rrëmbyeshëm dhe reshjeve të borës që goditën Ballkanin.

Në Kosovë përmbytjet kanë shkaktuar dëme në disa zona, por nuk ka viktima.

Në Gjermani reshjet e borës dhe erërat në veri pritet të kenë ndikim në shkolla, spitale dhe lidhjet e transportit.

Sipas Shërbimit Meteorologjik në Gjermani, në veri të shtetit mund të bien deri në 15 centimetra borë, ndërsa në jug ekziston rreziku i ngricave.

Temperaturat gjatë fundjavës mund të arrijnë deri në -20 gradë celsius, tha për AFP-në Shërbimi Meteorologjik gjerman.

Disa zona kanë njoftuar për mbylljen e shkollave të

premtën, përfshirë në Hamburg dhe Bremen.

Në Hamburg si pasojë e motit janë shkaktuar vonesa dhe anulime në rrjetin e transportit publik të enjten.

Kompania kombëtare hekurudhore Deutsche Bahn paralajmëroi për vonesa të konsiderueshme në ditët në vijim dhe tha se ka mobilizuar më shumë se 14 000 punonjës për ta pastruar borën nga shinat dhe platformat hekurudhore.

Shërbimi Meteorologjik gjerman tha se stuhia pritet të zgjasë deri të shtunën, ndërsa reshjet e borës do të ndalen të hënën.

Meteorologu Walter tha se kjo stuhi është një përjashtim krahasuar me vitet e fundit me dimra më të butë, të cilët janë “pasojë e ndryshimeve klimatike”.

Nga ky shërbim thanë se ka ende gjasa që i gjithë muaji të jetë i ftohtë dhe me borë, edhe pse temperaturat po rriten për shkak të ndryshimeve klimatike.

RUSIA E SULMON UKRAINËN ME RAKETËN BËRTHAMORE ORESHNIK

KIEV, 9 JANAR - Rusia lëshoi një raketë të re balistike me kapacitet bërthamor dhe me disa koka bërthamore drejt Ukrainës perëndimore si pjesë e një breshërie raketash dhe dronësh që goditën qytete ukrainase, përfshirë Kievin, ku të paktën katër persona u vranë dhe dhjetëra të tjerë u plagosën.

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha më 9 janar se përdorimi i raketës, e quajtur Oreshnik, ishte si përgjigje ndaj një sulmi të pretenduar me dronë nga Ukraina në fund të dhjetorit që, sipas Moskës, kishte për cak një rezidencë të përdorur nga presidenti rus Vladimir Putin.

Kievi e ka mohuar këtë pretendim, e CIA-ja e ka cilësuar të rremë.

Forcat ajrore të Ukrainës kishin paralajmëruar për një sulm me raketa nga një poligon testues në Rusi pak para mesnatës. Më vonë, forcat ajrore njoftuan se Rusia kishte lëshuar një raketë

balistike me shpejtësi të madhe.

Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kiev lëshoi një paralajmërim të pazakontë sigurie mbrëmjen e 8 janarit, duke sugjeruar se Moska mund t’i kishte njoftuar zyrtarët amerikanë më parë si mënyrë për ta shmangur alarmimin e Uashingtonit.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky gjithashtu kishte paralajmëruar për një sulm të mundshëm masiv ajror.

Ende nuk është e qartë nëse ka pasur viktima nga sulmi me këtë raketë. Disa video të postuara në “Telegram” dhe platforma të tjera nga kamera vëzhgimi në rajonin perëndimor të Llvit dukej se tregonin gjashtë objekte që goditën me shpejtësi.

Raportohet se raketa Oreshnik është e aftë të mbajë gjashtë koka bërthamore.

Kryetari i Llvit, Andriy Sadoviy, tha se sulmi goditi një objekt të infrastrukturës kritike dhe



shërbimet emergjente kishin dalë në vendngjarje.

Kjo është hera e dytë që Moska përdor raketën e re në luftën e saj kundër Ukrainës. Herën e parë Rusia e kishte përdorur raketën Oreshnik në nëntor të vitit 2024.

Putini është mburrur për aftësitë e kësaj arme dhe vitin e kaluar tha se po e dislokonte në Bjellorusi, aleaten e ngushtë të

Moskës. “Një sulm i tillë pranë kufirit të BE-së dhe NATO-s është një kërcënim i madh për sigurinë në kontinentin evropian dhe një test për komunitetin transatlantik”, tha ministri i Jashtëm Andriy Sybiha në një postim në X.

“Ne kërkojmë reagim të fortë ndaj veprimeve të pamatura të Rusisë”.

Sybiha gjithashtu njoftoi se

Ukraina do të nisë veprime ndërkombëtare, përfshirë një takim urgjent të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe një takim të Këshillit Ukrainë-NATO.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky kërkoi “një reagim të qartë nga bota”. “Mbi të gjitha nga ShBA-ja, sinjaleve të së cilës Rusia i kushton vërtet vëmendje”, shkroi ai në një postim në X.

Sulmi me raketën Oreshnik ishte pjesë e një breshërie dronësh dhe raketash që goditën qytete dhe fshatra ukrainas gjatë natës, përfshirë kryeqytetin, Kievin.

Zyrtarët thanë se të paktën katër persona humbën jetën në kryeqytet dhe më shumë se 24 u plagosën.

Sulmet ruse goditën gjithashtu qytetin Krivi Rih në Ukrainën qendrore. Ky rajon është përballur me ndërprerje të energjisë elektrike dhe të ujit për shkak të sulmeve ruse.

Grenlanda duhet të zhvillojë bisedime me ShBA-në pa Danimarkën, thotë lideri i opozitës

Nuuk, 9 janar - Grenlanda duhet të zhvillojë bisedime të drejtpërdrejta me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara pa përfshirjen e Danimarkës, ka thënë lideri i opozitës në ishullin danez, Pele Broberg.

Ishulli arkik është duke shqyrtuar se si t’u përgjigjet

përprjekjeve të presidentit Donald Trump që Shtetet e Bashkuara ta përvetësojnë ishullin.

Trumpi i ka shpeshtuar kërcënimet kohët e fundit për ta bërë Grenlandën pjesë të Amerikës, duke e ringjallur synimin që e kishte caktuar qysh në vitin 2019, gjatë mandatit të tij

të parë.

Grenlanda ndodhet në një pozicion strategjik midis Evropës dhe Amerikës së Veriut. Vendndodhja e bën atë pikë tejet të rëndësishme për sistemin amerikan të mbrojtjes kundër raketave balistike.

Burimet e saj të pasura minerare

përputhen gjithashtu me qëllimin e Uashingtonit për ta zvogëluar varësinë nga Kina.

Ishulli është territor autonom i Mbretërisë së Danimarkës. Ai i ka Parlamentin dhe Qeverinë e vet, por Kopenhaga gëzon autoritetin mbi punët e jashtme dhe për mbrojtjen.



NJË MILIARD EURO PËR KOSOVËN PO PRESIN NJË “PO” NGA DEPUTETËT

Mes pritjes për institucione të reja dhe rrezikut të shkuarjes përsëri në zgjedhje, qindra miliona euro nga Bashkimi Evropian dhe dhjetëra miliona të tjera nga Banka Botërore mbeten ende të pashfrytëzueshme nga Kosova. A do t'u thotë 'po' marrëveshjeve ndërkombëtare legjislatura e dhjetë e Kuvendit të Kosovës, pavarësisht se rrezikon shpërndarjen e mëvonshme?

PRISHTINË, 9 JANAR - Mbi një miliard euro po presin të shfrytëzohen nga Kosova që më shumë se një vit. Marrja e këtyre fondeve vazhdon të jetë peng i aprovimit nga Kuvendi i Kosovës.

Mungesa e institucioneve të reja përgjatë 2025-s ia pamundësoi shtetit përfitimin e 882 milionë eurove nga Plani për Reforma dhe Rritje i Bashkimit Evropian (BE) dhe të mbi 120 milionë eurove të tjera nga tri marrëveshje me Asociacionin Ndërkombëtar për Zhvillim (ANZh) të Bankës Botërore. Këto marrëveshje ndërkombëtare mbërritën në duart e deputetëve të legjislaturës së tetë të Kuvendit, në fund të vitit 2024. Ratifikimin po e presin që atëherë.

Çfarë pritet nga legjislatura e dhjetë?

Rezultati i zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit në Kosovë e bëri të qartë se do të ketë një shumicë të thjeshtë për konstituimin e Kuvendit 120-anëtarësh dhe për formimin e qeverisë së re. Por, për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ashtu sikurse edhe për zgjedhjen e presidentit të vendit, duhen 80 vota.

Nëse Kuvendi nuk do të arrijë ta zgjedhë presidentin as në votimin e tretë, që kërkon të paktën 61 vota nga jo më pak se 2/3 e deputetëve të pranishëm në sallë, vendin mund ta presin zgjedhje të reja në pranverë.

A do t'i miratojë Kuvendi marrëveshjet ndërkombëtare para se të rrezikojë një shpërndarje të radhës?

Lëvizja Vetëvendosje (LV), që i fitoi zgjedhjet parlamentare, llogarit në bashkëpunimin e opozitës që të zhbllokohen fondet e huaja për Kosovën.

Ish-nënkryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha për Radion Evropa e Lirë (REL) se LV-ja pret nga partitë opozitare që të mos e kushtëzojnë votimin e marrëveshjeve



ndërkombëtare me çështjen e presidentit. “Nuk besoj që marrëveshjet ndërkombëtare duhet të futen në diskutimet për çështjen e presidentit. Është e rëndësishme që Kuvendi t'i kryejë obligimet në lidhje me këto marrëveshje, ndërsa çështja e presidentit është një fazë tjetër, ku do të ketë diskutime. Presim vullnetin e tyre [të opozitës] për t'i votuar, dhe jo kushtëzime”, u shpreh Haxhiu.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) thonë se nuk do të jenë bllokues për sa i përket aprovimit të marrëveshjeve ndërkombëtare. “LDK-ja i ka votuar, dhe do të vazhdojë t'i votojë ato marrëveshje që janë në interes të Republikës së Kosovës”, tha Anton Quni, nënkryetar i LDK-së, në një deklaratë për REL-in.

Ndërkaq, nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) nuk iu përgjigjën thirrjeve të REL-it

për të komentuar për këtë çështje.

Megjithatë, kreu i PDK-së, Bedri Hamza, deklaroi ditë më parë para mediave se partia e tij i ka votuar marrëveshjet ndërkombëtare edhe në të kaluarën, dhe se do të kontribuojë për gjithçka që është në interes dhe në dobi të Kosovës.

Çfarë përmbajnë këto marrëveshje?

Nga Plani i Rritjes i BE-së për Ballkanin Perëndimor, Kosovës i takuan rreth 882 milionë euro, për të cilat Kosova ka miratuar agjendën e reformave.

Mbi 90 milionë euro është vlera e Marrëveshjes së Financimit, mbështetje buxhetore për Kosovën nga ANZh e Bankës Botërore, e cila synon t'i përmirësojë ligjet për financat publike dhe politikat fiskale. Ndërkaq, 21 milionë euro është vlera e Marrëveshjes së Kredisë

me ANZh-në për ndërtimin e çerdheve të reja për fëmijët, trajnimin e stafit dhe zbatimin e një skeme të kuponëve, përmes të cilëve familjet do të kenë mundësi t'i dërgojnë fëmijët e tyre në këto kopshte. E, Marrëveshja e Kredisë me ANZh-në, e destinuar për zhvillimin e Sistemit Informativ Shëndetësor në Kosovë, ka vlerën e 18 milionë e 600 mijë eurove.

A po u skadon afati fondeve?

Bekim Salihu nga Instituti për Studime të Avancuara - GAP thotë për REL-in se Kosova është vonuar në miratimin e këtyre marrëveshjeve dhe se po i nis me vonesë reformat e kërkuara nga BE-ja. “Fondet e Planit të Rritjes vlejnë deri në vitin 2027, ndërkohë që Kosova hyri në vitin 2026 pa i alokuar fondet dhe pa i nisur reformat. E rreziku shtesë është që mund

mungojë konsensusi politik në Kuvend për t'i miratuar”.

Për skadimin e afatit kishte paralajmëruar edhe komisionarja për Zgjerim e BE-së, Marta Kos, vitin e kaluar.

Të rrezikuara janë edhe miliona euro të tjera, për të cilat marrëveshja ishte nënshkruar në prillin e 2024-s. Javë më parë Zyra e Bankës Botërore në Kosovë pohoi për REL-in se afati i fundit për hyrjen në fuqi të marrëveshjes është 13 shkurti i vitit 2026.

Këto marrëveshje dështuan të miratoheshin në një seancë të mbajtur më 19 nëntor 2025, një ditë para se të shpërndahej Kuvendi, pasi opozita kishte refuzuar të shkonte në seancë, me arsyetimin se LV-ja kishte zvarritur procesin e formimit të institucioneve gjatë tërë vitit. Mbetet të shihet se a do t'i japë përbërja e re e Kuvendit dritën e gjelbër fondeve të huaja, edhe nëse rrezikon t'i shkurtojë jetëgjatësinë legjislaturës së dhjetë.

Vdiq Ali Sadriu, ish-ministër i Financave

PRISHTINË, 9 JANAR - Ka ndërruar jetë ish-ministri i Financave, Ali Sadriu, në moshën 75-vjeçare. Lajmin për ndarjen nga jeta të ish-ministrit Sadriu e kanë bërë me dije familjarët e tij.


Ali Sadriu ishte nga fshati Davidovc, komuna e Shtimes.

Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmin në Ferizaj. Studimet universitare i përfundoi në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë.

Ali Sadriu ishte gjithashtu iniciator, bashkëthemelues dhe aktivist i Lidhjes Demokratike të

Kosovës (LDK) në Shtime, që nga themelimi gjatë viteve 1989-2000. Ai ishte deputet i Kuvendit të Kosovës në disa legjislatura si dhe ministër në qeverinë e parë të pasluftës, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (2002-2004).





120 DEPUTETËT E LEGJISLATURËS SË RE TË KUVENDIT TË KOSOVËS

Të premten ka përfunduar numërimi i pjesës së fundit të fletëvotimeve nga votimi me postë jashtë Kosovës, duke shënuar kështu përfundimin e procesit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga zgjedhjet e 28 dhjetorit. Tashmë KQZ-ja është e gatshme për ta shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme të mbajtura më 28 dhjetor por, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, palët mund të parashetrojnë ndonjë ankesë në PZAP lidhur me administrimin e numërimit në QNR brenda 48 orëve nga ndodhja e shkëljes së supozuar

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 9 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka përfunduar numërimin e të gjitha votave për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit të cilat i fitoi Lëvizja Vetëvendosje me 51.11 për qind të votave. PDK-ja në këto zgjedhje ka fituar 20.19 për qind të votave, LDK-ja 13.23 për qind të votave dhe AAK-ja 5.50 për qind të votave. Me përfundimin e numërimit të këtyre fletëvotimeve, KQZ-ja është e gatshme ta shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme të mbajtura më 28 dhjetor por, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, palët mund të parashetrojnë ndonjë ankesë në PZAP lidhur me administrimin e numërimit në QNR brenda 48 orëve nga ndodhja e shkëljes së supozuar. Më së shumti ulëse në Kuvend do të ketë Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka siguruar 57 ulëse, PDK-

ja 22 ulëse, LDK-ja 15 ulëse, AAK-ja 6 ulëse, komuniteti serb 10 ulëse dhe komunitetet e tjera 10 ulëse. Ndërsa Nisma Socialdemokrate nuk ka arritur të kalojë pragun për dallim nga zgjedhjet e kaluara në të cilat garoi në koalicion me AAK-në dhe kishte tre deputetë. Në zgjedhjet e 28 dhjetorit morën pjesë rreth 45 për qind e gati 2 milionë qytetarëve me të drejtë vote. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit janë rezultat i mospajtimeve dhe përplasjeve ndërmjet partive politike të cilat pas zgjedhjeve të 9 shkurtit nuk arritën ta konstituonin Kuvendin deri më 10 tetor. Kurti më pas nuk arriti t'i marrë votat e mjaftueshme në Kuvend për formimin e qeverisë. Qeverinë nuk arriti ta formojë as i mandatuari i dytë, Glauk Konjufca, po nga LV-ja, gjë që detyroi presidenten Osmani t'i shpallë zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

- Deputetët e LV-së:**
1. Albin Kurti
 2. Glauk Konjufca
 3. Albulena Haxhiu
 4. Hekuran Murati
 5. Donika Gërvalla
 6. Xhelal Sveçla
 7. Hajrulla Çeku
 8. Avni Dehari
 9. Mimoza Kusari-Lila
 10. Ejup Maqedonci
 11. Shqipe Mehmeti - Selimi
 12. Andin Hoti
 13. Arben Vitia
 14. Saranda Bogujevci
 15. Alban Bajrami
 16. Edona Llalloshi
 17. Mefail Bajqinovci
 18. Nezir Kraki
 19. Rufki Suma
 20. Jeta Statovci
 21. Adriana Matoshi
 22. Armend Muja
 23. Ardian Gola
 24. Haxhi Avdyli
 25. Adelina Grainca
 26. Blerim Gashi
 27. Albena Reshitaj
 28. Taulant Kelmendi
 29. Fatos Geci
 30. Fitore Pacolli-Dalipi
 31. Agim Bahtiri
 32. Artane Rizvanolli-Berisha
 33. Dimal Basha
 34. Arbër Rexhaj
 35. Labinotë Demi-Murtezi
 36. Arbëreshë Kryeziu-Hyseni
 37. Hysen Durmishi
 38. Arjeta Fejza
 39. Artan Abrashi
 40. Arbërie Nagavci
 41. Enver Haliti
 42. Liza Gashi
 43. Valon Ramadani

44. Adnan Rustemi
 45. Fatmire Kollçaku
 46. Drita Pajaziti
 47. Jeton Raka
 48. Arsim Ademi
 49. Rozeta Hajdari
 50. Fitim Haziri
 51. Salih Zyba
 52. Fjolla Ujkani
 53. Ilir Kërçeli
 54. Sylejman Mehulli
 55. Valon Hoti
 56. Vigan Qorrolli
 57. Naim Bardiqi
- Deputetët e PDK-së:**
1. Bedri Hamza
 2. Arian Tahiri
 3. Përparim Gruda
 4. Uran Ismaili
 5. Sala Jashari
 6. Vlora Çitaku
 7. Enver Hoxhaj
 8. Arben Mustafa
 9. Nait Hasani
 10. Rrahman Rama
 11. Eman Rrahmani
 12. Ganimete Musliu
 13. Kujtim Gashi
 14. Elmi Reçica
 15. Artan Behrami
 16. Xhavit Haliti
 17. Besa Kabashi-Ramaj
 18. Mërgim Lushtaku
 19. Ferat Shala
 20. Blerta Deliu-Kodra
 21. Ariana Musliu-Shoshi
 22. Arbnore Salihu
- Deputetët e LDK-së:**
1. Lumir Abdixhiku
 2. Hykmete Bajrami
 3. Ukë Rugova
 4. Avdullah Hoti
 5. Doarsa Kica-Xhelili
 6. Kujtim Shala

7. Anton Quni
 8. Armend Zemaj
 9. Lutfi Haziri
 10. Jehona Lushaku-Sadriu
 11. Janina Ymeri
 12. Besian Mustafa
 13. Adelina Thaqi-Meta
 14. Fadil Hadergjonaj
 15. Ermal Sadiku
- Deputetët e AAK-së:**
1. Ramush Haradinaj
 2. Daut Haradinaj
 3. Besnik Tahiri
 4. Bekë Berisha
 5. Time Kadrijaj
 6. Albana Bytyqi
- Lista Serbe**
1. Slavko Simiq
 2. Igor Simiq
 3. Ljiljana Stefanoviq
 4. Milan Kostiq
 5. Nemanja Bishevac
 6. Zlatan Elek
 7. Miljana Nikoliq
 8. Srdjan Popoviq
 9. Verica Çeraniq
- Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë**
1. Nenad Rashiq
- Komunitetet joserebe**
1. Fikrim Damka
 2. Fatma Taqi
 3. Rasim Demiri
 4. Emilija Rexhepi
 5. Elbert Krasniqi
 6. Duda Balje
 7. Veton Berisha
 8. Artan Asllani
 9. Adem Hoxha
 10. Erxhan Galushi

PËRFUNDON NUMËRIMI I TË GJITHA VOTAVE PËR ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 JANAR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka përfunduar të premtën numërimin e të gjitha votave për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, të cilat i fitoi Lëvizja Vetëvendosje me 51.11 për qind të votave.

Tani KQZ-ja është e gatshme ta shpallë rezultatin përfundimtar, tha zëdhënësi i këtij institucioni, Valmir Elezi. “Por, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, palët mund të parashetrojnë ndonjë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia lidhur me administrimin e numërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”, ka theksuar Elezi.

Grupi i fundit i fletëvotimeve që u numëruan ishin ato me postë, numërimi i të cilëve përfundoi në orën 02:00 të 9 janarit.

Pikërisht për votat me postë, në PZAP është dërguar një ankesë nga Partia Demokratike e Kosovës e cila ka kërkuar shfuqizimin e mijëra votave të diasporës që kanë ardhur në Kosovë me postë.

Sipas rezultateve preliminare, LV-ja e Albin Kurtit ka shënuar rezultatin më të mirë në zgjedhje ndonjëherë, duke fituar 51.11 për qind të votave apo përkthyer në vota, ky subjekt mori 486 994 vota që i japin 57 vende në Kuvend.

Kreu i kësaj partie, Albin Kurti, është personi më i votuar në Kosovë, pasi ka marrë 404 023 vota.

Partia e dytë doli Partia Demokratike e Kosovës me 20.19 për qind të votave apo 22 vende në Kuvendin prej 120 deputetësh.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka fituar 13.23 për qind të votave, që i sigurojnë asaj 15



vende në organin ligjvënës.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka fituar 5.50 për qind të votave dhe kjo parti do të ketë gjashtë deputetë.

Lista Serbe - partia kryesore e serbëve në Kosovë, e afërt me Beogradin zyrtar - do të ketë nëntë nga dhjetë vendet e garantuara për komunitetin serb. Një deputet nga radhët e komunitetit serb do ta ketë Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiqit. Ndërkaq, të dhjetë vendet e tjera të garantuara për komunitetet pakicë joserbe janë shpërndarë në disa parti dhe koalicione.

Në zgjedhjet e 28 dhjetorit morën pjesë 45 për qind e trupit votues.

LV-ja e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se synon formimin e shpejtë të institucioneve të reja pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit ishin rezultat i mospajtimeve dhe përplasjeve ndërmjet partive poli-

tike, të cilat pas zgjedhjeve të 9 shkurtit nuk arritën ta konstituonin Kuvendin deri më 10 tetor.

Kurti më pas nuk arriti t'i merrte votat e mjaftueshme në Kuvend për formimin e qeverisë, por as Glauk Konjufca nga LV-ja.

PDK-ja kërkon shfuqizimin e mijëra votave me postë

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar zyrtarisht shfuqizimin e rreth 20 000 votave të dërguara në vend përmes postës nga mërgata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, duke u thirrur në shkelje ligjore.

PDK - e cila doli e dyta në zgjedhje - parashtror ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) të enjten. Ajo tha se mbi 20 000 fletëvotime ishin dërguar me postë nga jashtë vendit me vonesë, pas afatit të lejuar ligjor.

Ditë më parë zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valmir Elezi, tregoi se komisioni, i cili mbikëqyr procesin zgjedhor në vend - i kishte pranuar rreth 20 000 fletëvotime të dërguara me postë nga mërgata në fillim të janarit. “Janë rreth 20 mijë pako me fletëvotime të tërhequra më 2 dhe 5 janar që pritet të numërohen së shpejti”, tha Elezi më 5 janar.

Sipas Ligjit të Kosovës për Zgjedhjet, fletëvotimet e dërguara me postë nga jashtë vendit mund të pranohen nga KQZ-ja më së largu një ditë pas zgjedhjeve.

Neni 96 thotë se “vota përmes votimit jashtë Kosovës, e dërguar me postë në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë, pranohet nga KQZ-ja deri të nesërmen e ditës së zgjedhjeve në orën 16:00, me kusht që të ketë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve”.

Anëtarë i PDK-së në KQZ, Ilir Gashi, shkroi të enjten në

“Facebook” se propozimi për pranimin e fletëvotimeve pas afatit u miratua në KQZ “me vetëdije se po bëhej shkelje ligjore, edhe pse kjo u arsyetua me qëllimin që të mos keqkuptohej se jemi kundër mërgatës”. “Prandaj, organet kompetente duhet të vendosin në mënyrë meritore lidhur me vendimin e KQZ-së për pranimin e fletëvotimeve jashtë afatit ligjor”, shkroi Gashi.

Por, Alban Krasniqi - anëtarë i Lëvizjes Vetëvendosje në KQZ, e cila i fitoi bindshëm zgjedhjet, përfshirë edhe votat me postë, - e akuzoi PDK-në për ankesë të “turpshme” kundër mërgatës. “Vetë e votuan në KQZ procedurën dhe afatet, e tash kur mërgata u vetorganizua dhe arriti të sjellë fletëvotimet nga gjithandej globit, këtyre u djeg ky fakt duke harruar që humbjen nuk e kanë nga mërgata, e as nga votuesit në Kosovë, por nga sjellja, veprimet dhe vendimet e dëmshme të vet PDK-së”, shkroi Krasniqi në “Facebook”.

Cakolli: Gjasat për zgjedhje janë reale, mund të mbahen në javën e dytë të prillit



PRISHTINË, 9 JANAR - Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës ka thënë për RTV21 se nuk e përjashton mundësinë e zgjedhjeve të reja në prill të këtij viti. Siç vlerësoi ai, mosgatishmëria e liderit të LV-së, Albin Kurti, që të ketë një koalicion me ndonjë parti për pozitën e presidentit, bën që gjasat për zgjedhje janë reale. “Megjithatë unë besoj që mund të gjendet ndonjë zgjidhje deri në atë kohë, por nëse do të kemi zgjedhje, ato do

të mbahen në javën e dytë të muajit prill, respektivisht diku nga data 1 deri më 20 prill”, ka thënë ai. Sipas Cakollit, presidenti duhet të votohet më së largu deri më mars, ose vendi do të shkojë automatikisht drejt zgjedhjeve të parakohshme.

Më tutje, ai tha se presioni më i madh për votat për presidenten Vjosa Osmani do t'i bie LDK-së. “Meqenëse LV pritet t'i ketë 57 deputetë, numër të cilit, nëse i shtohen edhe 11 deputetët nga

komunitetet joshumicë dhe një nga komuniteti joserb, atëherë e çon numrin në 68 deputetë, por që zakonisht partitë janë kujdesur që mos ta lënë për një deputet dhe, natyrisht, barra më e madhe e presionit do të bie mbi LDK-në, për faktin se po tentohet që të gjendet një fajtor kujdestar në rast të dështimit të zgjedhjes së presidentit”, ka thënë ai. Cakolli ka theksuar se Kurtit nuk i bëhet vonë nëse dështon zgjedhja e presidentit, pasi që ka tri mandate.

OPOZITA NË VDEKJE KLINIKE!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Përfunduan zgjedhjet klienteliste: Zgjedhjet e 28 dhjetorit (data e kurdisur nga padroni Kurthi dhe rrogëtarja Osmani) përfunduan ashtu si e planifikuan në ekipin e Kurthit, LV-ja doli e para, kurse tri partitë opozitare humbën 9 deputetë. Nëse kemi parasysh se infrastruktura shtetërore, oligarkët e Kurthit dhe forcat informale ishin angazhuar në anën e regjimit, plus 300-400 milionë që Kurthi i ndau ekskluzivisht për blerje të votave, kjo fitore ishte si “fitorja e Pirros”. Vetëm në ambasada dhe qendra konsullore u pa se n’masë është kriminalizuar Ministria për Punë të Jashtme dhe Diasporë pasi u shndërruan në pika të LV-së duke votuar mbi 90 për qind. Përqindje e denjë për regjimet totalitariste. Por ky i fundit çfarë na qenka? “Demokraci autokrate”! Mërgata (një pjesë e saj) e manipuluar dhe e korruptuar nga Kurthi e deligjitimoi votën e banorëve të përhershëm të Kosovës duke e përmbysur rezultatin që është në kundërshtim të plotë me zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike. I dhanë goditje të madhe Kosovës dhe u kthyen në vendet ku nuk kanë probleme që i kemi ne, nuk i bartin pasojat e votës së tyre klienteliste. Nuk përballen, ende pa u certifikuar rezultatet e kurdisura, me fatura të ujit 50 për qind më të larta dhe së shpejti me fatura të rrymës kush e di sa më të larta ndërkaq që rrogat dhe pensionet janë së paku 8 herë më të ulëta se në vendet ku jetojnë. Nuk përballen me reduktime t³ë mëdha të furnizimit me rrymë, ujë dhe nuk mbulohen nga plehrat. Shumica e artikujve të domosdoshëm në Kosovë janë me çmime më të larta se në shtetet ku jetojnë. Ata nuk

përballen atje me analfabetizmin që po përhapet në Kosovë, nuk vdesin për një ilaç apo intervenim mjekësorë. Të ne baballarët dhe familjarët e pushtetit ani pse kur nuk kanë bërë asgjë për këtë vend kurse shumë për Serbinë marrin para jashtë rendit dhe sa të duan, mjekohen në qendra mondane shëndetësore, bëjnë ndërhyrje estetike për ta kompensuar atë që nuk ua ka dhënë natyra kurse të merituarit, ish të burgosurit politikë dhe ushtarë të UÇK-së, si Gani Koci nuk kanë kujdes institucional as për një vdekje të dinjitetshme!

Po opozita, keni dëgjuar për të: Nëse luftoni për mbijetesë, mos u bëni fare pjesë e garës, cucni aty në mjerimin dhe pafuqinë tuaj. E tillë ishte dhe është opozita në Kosovë. Që nga zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 nuk pati guxim dhe nuk ndërmori asnjë veprim opozitar ndonëse vendi gufonte prej skandaleve qeveritare dhe institucionale. Që nga përfundimi i luftës në Kosovë asnjëherë opozita nuk ka pasur më shumë mundësi ta deklasojë pozitën se tani. Ndodhi e kundërta, një pozitë e zhytur deri në fyt në punë të këqija, antishtet dhe antikombëtare të gjitha këto i zbrazi në xhirollogarinë politike të opozitës. Bllokimin institucional me mashat Avni Dehari, Lenka Haxhiu, Nenad Rashiq dhe Glauk Konjufca, Kurthi i materializoi duke i përkthyer në vota pasi e fajësoi opozitën, klinikisht thuaja të vdekur. Opozita vullnetarisht u shtri në arkmortin kur iu nënshtrua shantazhit të Kurthit dhe Imelda Markosit të Kosovës, Vjosa Osmani që zgjedhjet të mbahen më 28 dhjetor 2025. Gozhdimi në arkmort filloi me pranimin e rezultatit të

zgjedhjeve nga ana e opozitës të cilat nuk ishin as të lira, as të drejta e më së paku demokratike. Për shkak të vënies së resurseve institucionale, shtetërore dhe materiale në shërbim të një partie, u krijuan kushte të pabarabarta midis subjekteve garuese ku fituesi ishte i paracaktuar. Albin Kurthi duke futur në lojë 300-400 milionë në javën e fundit para zgjedhjeve i futi në lojë së paku 650.000 votues (studentë, pensionistë, shërbyes civilë, familjeve që kanë fëmijë, etj). Nuk mbahet në mend të ketë ndodhur më parë një korrupsion elektoral aq i strukturuar dhe i paskrupullt se në këto zgjedhje. Prandaj nuk duhet të pranohen këto zgjedhje. Gabimin e fundit që mund ta bëjë opozita e që përfundimisht do ta dërgonte në varreza të subjekteve politike pa mundësi ringjalljeje edhe përmes reanimacionit më të përparuar është bërja e kuorumit edhe për një mandat presidencial për Imelda Markosin e Kosovës me emër konspirativ, Vjosa Osmani. Askush nuk e ka dëmtuar më shumë opozitën e sidomos LDK-në se rrogëtarja e Kurthit, Vjosa Osmani duke vepruar si aktiviste e LV-së dhe duke përçarë skenën politike dhe jo vetën politike se kjo hije e zezë e Kurthit. Prandaj, bërja eventuale e kuorumit për këtë përçarëse do të ishte fatale për opozitën dhe vdekjeprurëse për LDK-në. Imelda Markos alias Vjosa Osmani kërkoi edhe një mandat për të vazhduar punët e mira... për të dhe familjen e saj. Për Kosovën asgjë të mirë nuk ka bërë përveç zhagitjes pas Kurthit. Opozita nuk duhet të pranojë asnjë kandidat konsensual që propozohet nga Kurthi sepse konsensualiteti për

Kurthin nënkupton nënshtrim 100 për qind ndaj Kurthit. Raporti 57 deputetë të pozitës ndaj 43 të opozitës duket i madh mirëpo nëse opozita organizohet si duhet nuk do ta lë pozitën as frymë të marrë nëse nuk punon si dhe sa duhet. Opozita duhet të bëjë opozitarizëm në Kuvend, duke kundërshtuar shpërdorim të ligjeve në Gjykatën Kushtetuese dhe varësisht nga zhvillimi i ngjarjeve edhe duke protestuar në rrugë. Opozita ose duhet të sillet si opozitë ose pashmangshëm do të përfundojë në recycle been - shportë të mbeturinave. Opozita ka deputetë shumë më të zotë në aspektin profesional se pozita, deputetë që kanë të kaluar kombëtare dhe politike si dhe integritet moral. Pozita ka agimbahtira, dimalbasha, hekuramurata, korin e pevaçicave tallava dhe pevaçicave të Arkanit, haxhiqamila dhe të ngjashëm. Pozita i ka mbyttë të burgosurit politikë, e ka vra UÇK-në, i ka shpërfillur vlerat kombëtare. Shiheni listën e LV-së, ata që kanë një të kaluar kombëtare e që janë bërë bashkë me udbashët e shumtë në LV, ose nuk e kanë kaluar fare pragun për deputetë, ose janë bira e fundit e kavallit si puna e Saliut. E patë se si i shantazhoi Vojsa Osmani deputetët e opozitës? Se, nëse nuk e votojnë do të përballen me të në zgjedhje thuaja se e ka partinë me 400.000 anëtarë! Pastaj ai Peci që u bë kryetar me vota të vjedhura në Mitrovicë. Merreni me mend pec e aq ulët kërcënon dhe shantazhon, po të ishte më i madh se peci, ku do të përfundonte ky servil i Kurthit dhe Shvarcit. Të gjithë e kanë të qartë se LV-ja është vet dhe vetëm Kurthi. Ai është baba i LV-

së, ndërsa Dejona është majka e LV-së. Pa Kurthin LV-ja do të shndërrohej në jetimore sepse majka Dejona do t’ia mbathte për Greqi apo Serbi, bashkë me Mimoza Kusarin. Mimoza e përzemërt me Radoiçiqin dhe Simiqin në telefon kundër UÇK-së dhe veteranëve të luftës. Mimoza e përzemërt me këtë inxhen nga Serbia në Solloturn të Zvicrës. Bashkë me Fifin e IV-së, Lutën e LDK-së dhe Bernardin e PDK-së duke u çmallur me “kriminelët” e Serbisë që një muaj më parë në Banjskë e vranë policin Afrim Bunjaku. Nuk kanë pritur as të pamet të përfundojnë, merreni me mend. Besnik Rrenc Bislimi u nxor nga situata si miza e kalit kur ndërron ambient. Albin Kurthi po blenë kohë me luftën e Ukrainës duke ikur nga zbatimi i Marrëveshjes së Brukselit dhe aneksit të Ohrit që serbëve të Kosovës iu garanton autonomi politike dhe territoriale duke e shndërruar Kosovën në federatë (a)simetrike. Me kontributin antikombëtar të projugosllavit Surroi dhe mercenarit Weller.

Nuk ka përgjegjësi për arrivistët: Nuk e di se çka duhet të ndodhë që për shkak të dështimit, të dështuarit të dorëhiqen. Në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Luginë, dorëheqja shkaku i dështimit është e paimagjinueshme. Kërkohet përkrahja nga të hurit e të konopit vetëm të mbesin aty ku janë. Hyhet në aleanca të paimagjinueshme vetëm të ruhet një territor i karriges të përmasave të prapanicës të personit të dështuar. Deri më tani vetëm një lider ka ofruar argumente bindëse pse nuk dorëhiqet. Ai është Ali Ahmeti. Nëse Ali Ahmeti do të dorëhiqej, Ismet Sylejmani do të mbetej pa punë! E si mos të bindem!!!!

Mbetje eshtërore gjenden në Gjakovë, dyshohet se u përkasin viktimave të luftës

Gjakovë, 9 janar - Mbetje eshtërore, të cilat dyshohet se i përkasin një personi të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, janë gjetur në komunën e Gjakovës. Lajmin e ka dhënë Policia e Kosovës përmes një komunikate për medie. “Ekipet policore, në koordinim me Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe njësitë e tjera kompetente, kanë hasur në mbetje eshtërore, të cilat dyshohet se i përkasin së paku një individi që figuron në

listën e personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë (1998-1999)”, thuhet në raportin 24-orësh të policisë. Mbetjet eshtërore janë dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për ekzaminime të mëtejshme mjeko-ligjore. Kosova dhe Serbia kishin arritur marrëveshje për personat e zhdukur në kuadër të procesit të dialogut në korrik të vitit 2023. Në dhjetor të vitit 2024, gjithashtu,

kryenegociatori i Prishtinës dhe ai i Beogradit ishin pajtuar për zbatimin e Deklaratës së Përbashkët për Personat e Zhdukur me Dhunë, gjatë një takimi trelateral në Bruksel. Kjo deklaratë përmban zotime për të siguruar qasje të plotë në informacione, mes tyre edhe dosje sekrete, për t'i vënë në dispozicion të gjitha dokumentet me rëndësi për përcaktimin e fatit të personave të zhdukur; si dhe për të bashkëpunuar përmes

një komisioni të udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Por, përkundër se ajo synon avancimin e procesit të gjetjes dhe identifikimit të personave të zhdukur nga periudha e luftës së fundit, shumë pak është bërë në këtë drejtim, kryesisht për faj të Serbisë. Autoritetet e Kosovës kanë thënë se zbardhja e fatit të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë është urgjencë kombëtare dhe humanitare.



Por, shteti serb nuk është treguar i gatshëm për të dhënë informacione rreth varrezave masive të mbi 1 584 shqiptarëve etnikë të Kosovës të zhdukur prej më shumë se dy dekadave.

HAMZA: RUAJTJA E VOTËS SONË ËSHTË DËSHMI SE MIJËRA QYTETARË BESOJNË NË VLERAT E PDK-së



PRISHTINË, 9 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka reaguar pas përfundimit të numërimit të votave për zgjedhjet e 28 dhjetorit. Ai ka thënë se në një garë të vështirë dhe të pabarabartë, ruajtja e votës së tyre është dëshmi se mijëra qytetarë besojnë në punën, seriozitetin dhe vlerat që PDK-ja i përfaqëson. “Numërimi i votave ka përfunduar. Partia

Demokratike e Kosovës ka marrë 192,407 vota dhe është renditur e dyta. Këtë besim e marrim me përgjegjësi të madhe. Në një garë të vështirë dhe të pabarabartë, ruajtja e votës sonë është dëshmi se mijëra qytetarë besojnë në punën, seriozitetin dhe vlerat që PDK-ja i përfaqëson. Ky besim na obligon më shumë se kurrë që të riorganizohemi, t'i konsolidojmë radhët tona dhe

ta intensifikojmë veprimin politik”, ka shkruar Hamza në “Facebook”. Ai ka thënë se PDK-ja do të vazhdojë të punojë për çdo qytetar, pa dallim, në çdo platformë ku janë të pranishëm, me këmbëngulje dhe me bindjen se Kosova meriton më shumë dhe më mirë. “Faleminderit për besimin! Puna jonë vazhdon!”, ka shkruar Hamza.

ABDIXHIKU: LDK-ja ËSHTË MË E MADHE SE ÇDO INDIVID, PAS CERTIFIKIMIT TË REZULTATEVE DO TA MBAJTMË KUVENDIN E PARTISË

Prishtinë, 9 janar - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas përfundimit të numërimit të votave, duke falënderuar 126 mijë votuesit e kësaj partie që i besuan në zgjedhjet e 28 dhjetorit. Ai ka thënë se çdo votë e dhënë për LDK-në është përgjegjësi, respekt dhe obligim për të ardhmen. “Ju faleminderit për besimin, për durimin dhe për angazhimin në një garë të vështirë. Nuk është e tepërt të përsëritet se rezultati zgjedhor nuk ishte ai që pritëm; larg madje. Por është verdikt i qytetarëve të vendit tonë dhe para tij përulemi me respekt të plotë. LDK e asnjë individ nuk i

shmanget asnjë përgjegjësie dhe asnjë reflektimi; kjo na dallon. Dalim faqebardhë në secilin veprim tonin”, ka shkruar ai në “Facebook”. Ai ka theksuar se LDK-ja është parti institucionale. “Çështjet tona nuk zgjidhen në statuse emocionale, as në klithma sociale, e as në debate të çastit. Pas certifikimit të rezultateve, sipas Statutit dhe traditës sonë demokratike, do të mbledhet Kryesia e LDK-së; dhe pas saj, siç kam paralajmëruar natën e zgjedhjeve, do të organizohet dhe Kuvendi i LDK-së, aty ku vendosë anëtarësia, e jo klithmat e interesave të ngushta. Në Kuvend, në organet



legjitime të partisë, nga anëtarësia e partisë, vendoset fati i LDK-së. Aty do të trajtohen të gjitha çështjet politike, organizative dhe vendimmarrëse - mbi të gjitha

të përgjegjësisë dhe të vizioneve tutje përpara. Kjo është mënyra jonë. Kjo ka qenë gjithmonë LDK-ja: përgjegjësi, maturi, rend institucional dhe respekt për demokracinë e brendshme”,

ka shkruar Abdixhiku. Abdixhiku ka thënë se një fjalë të drejtpërdrejtë ka dhe për ata që sot po e godasin LDK-në nga jashtë. “Qëllimet e tyre nuk kanë qenë kurrë të mira, as për LDK-në e as për arritjen e një rezultati më të mirë zgjedhor. LDK-ja nuk ndërtohet me sulme nga jashtë, e as me gëzim për humbjen e saj. LDK është më e madhe se çdo individ, por edhe më e fortë se çdo zë që synon ta dobësojë. Ne do ta bëjmë fatin tonë, me qetësi, me ndershmëri dhe me përgjegjësi; siç i ka hije kësaj shtëpie politike e cila nuk braktiset e as nuk goditet në ditët e saja më të vështira”, ka thënë ai.

Mbyllet një urë në veri shkaku i dëmtimeve nga vërshimet

Mitrovicë, 9 janar - Drejtorja Rajonale e Policisë në Mitrovicë Veri ka njoftuar se pas situatës së krijuar si pasojë e vërshimeve të fundit, gjendja e sigurisë dhe rendit publik në veri të vendit është nën monitorim të vazhdueshëm. “Policia e Kosovës në vazhdimësi ka qenë e angazhuar në terren dhe në koordinim të plotë me institucionet e tjera relevante, përfshirë komunat përkatëse, Njësinë e Zjarrfikësve dhe

Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, me qëllim të menaxhimit të situatës dhe parandalimit të rreziqeve të mundshme për qytetarët. Vërshime janë evidentuar në qytetin e Zveçanit dhe në Mitrovicë Veri. Ndërkaq, më 08.01.2025 Policia e Kosovës ka pranuar informata se në fshatin Beluçë të Leposaviqit, si pasojë e vërshimeve, një urë ka pësuar dëmtime, ku njëra këmbë e urës është dëmtuar. Lidhur me këtë

rast, policia i ka njoftuar zyrtarët komunalë të Leposaviqit si dhe përfaqësuesit nga Ministria e Infrastrukturës të cilët kanë dalë në terren dhe kanë konstatuar se, për shkak të rrezikut për sigurinë, ura duhet të mbyllet. Si rezultat, ura është mbyllur përkohësisht deri në një vendim të radhës”, ka njoftuar Policia e Kosovës. Po gjatë këtyre ditëve në qytetin e Mitrovicës së Veriut janë evakuuar katër familje pasi

shtëpitë e tyre janë përmbytur si pasojë e vërshimeve. Situata aktualisht është e menaxhueshme dhe Policia e Kosovës po vazhdon monitorimin e gjendjes në terren. Qytetarët për çdo vështirësi apo rast emergjent mund ta kontaktojnë Policinë e Kosovës në numrin 192. Policia e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar për ofrimin e shërbimeve, mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve,



veçanërisht në situata emergjente kur vendi përballet me rreziqe natyrore.


Hapen regjistrimet për Panairin Ndërkombëtar të Turizmit "Kosova 2026"

PRISHTINË, 9 JANAR - Bizneset dhe individët e industrisë së turizmit tashmë mund të regjistrohen për të marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Turizmit "Kosova 2026", ngjarja më e madhe e turizmit në vend.

Ky panair ofron një mundësi unike për t'i promovuar produktet dhe shërbimet turistike para partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe për të krijuar rrjete bashkëpunimi dhe mundësi të reja biznesi. "Ky panair synon

të fuqizojë sektorin e turizmit në Kosovë dhe të lidhë aktorët vendorë me partnerët ndërkombëtarë, duke promovuar potencialin turistik të vendit tonë", thonë organizatorët. Ngjarja pritet të tërheqë

kompani turistike, agjenci udhëtimesh, operatorë hotelesh dhe profesionistë të industrisë nga vendi dhe jashtë, duke bërë të mundur prezantimin e ofertave turistike në një platformë ndërkombëtare të promovimit.



OEK-u DHE AKB-ja: ZJARRI NË 'COMODITA', HUMBJE E MADHE PËR EKONOMINË

PRISHTINË, 9 JANAR - Oda Ekonomike e Kosovës ka shprehur keqardhjen e thellë për zjarrin që përfshiu një pjesë të objektit të kompanisë 'Comodita Home' në Gjakovë, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale. OEK-u ka theksuar se ky incident përbën një humbje të madhe jo vetëm për kompaninë 'Comodita' dhe 'Devolli Corporation', por edhe për ekonominë e Gjakovës dhe të gjithë Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që ky grup ka në zhvillimin ekonomik, punësimin dhe kontributin fiskal në vend. "Duke pasur parasysh se 'Devolli Group' është ndër taksapaguesit më të mëdhenj në Kosovë dhe një nga shtyllat kryesore të sektorit privat, Oda Ekonomike e Kosovës i bën thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës që të ofrojë mbështetje institucionale dhe financiare, në mënyrë që kjo kompani të rikuperohet sa më

shpejt dhe ta vazhdojë aktivitetin e saj afarist. Oda Ekonomike e Kosovës qëndron pranë kompanisë 'Comodita' dhe 'Devolli Group', duke shprehur mbështetje të plotë në përpjekjet për rikuperim dhe vazhdim të aktivitetit të tyre afarist. OEK është e bindur se kjo kompani do ta tejkalojë këtë situatë të vështirë dhe do të vazhdojë të kontribuojë fuqishëm në zhvillimin ekonomik të vendit", thuhet në reagim.

OEK-u rithekson rëndësinë e mbrojtjes së bizneseve dhe infrastrukturës ekonomike si faktor kyç për stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve - Zyra e Rrafshit të Dukagjinit, menjëherë pas lajmit për këtë incident, ka zhvilluar biseda telefonike me drejtuesit e kësaj kompanie, për t'u informuar nga afër mbi situatën aktuale, rrethanat e zjarrit dhe pasojat që ka shkaktuar kjo



fatkeqësi. Gjatë këtyre bisedave është shprehur shqetësimi i thellë dhe solidariteti i plotë i AKB-së me menaxhmentin dhe punëtorët e fabrikës së prekur. Edhe Aleanca Kosovare e Bizneseve ka theksuar se mbrojtja e vendeve të punës dhe ruajtja e kapaciteteve prodhuese duhet të jenë prioritet institucional. Sipas AKB-së, bizneset prodhuese janë shtylla e zhvillimit ekonomik dhe garant i stabilitetit social. "Çdo goditje ndaj tyre është një goditje ndaj gjithë shoqërisë. AKB-ja do të vazhdojë të jetë pranë këtij biznesi dhe të gjithë bizneseve të prekura nga fatkeqësi të tilla, duke kërkuar mbështetje konkrete, politika mbrojtëse dhe reagim serioz shtetëror. Në këto çaste të vështira, solidariteti, përgjegjësia dhe veprimi i shpejtë janë thelbësore. Gjakova dhe bizneset e saj meritojnë përkrahje reale dhe jo heshtje", është thënë në reagimin e AKB-së.

LLUGALIU: VITI 2025 KONFIRMOI REKORDE TË REJA PËR DOGANËN E KOSOVËS

PRISHTINË, 9 JANAR - Drejtori i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka bërë me dije se viti 2025 ka siguruar vijimësinë e rezultateve rekord për këtë institucion, duke e cilësuar atë si një vit të performancës së lartë fiskale, operacionale dhe institucionale.

Në një postim të publikuar në rrjetin social "LinkedIn", Llugaliu thekson se të hyrat e Doganës kanë arritur në 1.965 miliard euro, me një rritje prej 132 milionë eurosh krahasuar me vitin 2024 dhe mbi 3.5 për qind më shumë se projeksoni qeveritar. Sipas tij, këto rezultate janë dëshmi e menaxhimit efikas edhe në kushte të politikave lehtësuese



për bizneset.

Llugaliu sqaron se vetëm gjatë vitit 2025 lirimet nga taksat për prodhuesit dhe nga marrëveshjet e tregtisë së lirë kanë arritur vlerën prej 67 milionë eurosh, duke e çuar totalin e taksave të liruara në

këto kategori në 407 milionë euro. Drejtori i Doganës vë në pah edhe shtimin e luftës kundër ekonomisë joformale, e cila ka ndikuar në rritjen e qëndrueshme të të hyrave, pothuajse dy herë më shpejt se rritja ekonomike.

Ndërkohë, sekuestrimet dhe konfiskimet kanë tejkaluar ndjeshëm nivelin e vitit 2024 dhe janë mbi katër herë më të larta krahasuar me vitin 2019. Sipas Llugaliut, mbrojtja e shoqërisë është forcuar përmes goditjeve të drejtpërdrejta ndaj narkotikëve, armëve, eksplozivit dhe mallrave të rrezikshme, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sigurisë së vendit.

Ai nënvizon se, sipas të dhënave të CEFTA-s, Kosova prin në rajon për kohën më të shpejtë të zhdoganimit, duke e pozicionuar Doganën e Kosovës si një nga administratat më efikase doganore në Ballkanin Perëndimor.

Në fokus të zhvillimit institucional, Llugaliu përmend reformat e vazhdueshme, digjitalizimin dhe inovacionin, përfshirë përdorimin e inteligjencës artificiale në menaxhimin e riskut dhe sistemet "Track & Trace", që po e bëjnë Doganën më moderne dhe më funksionale.

Po ashtu, ai thekson rëndësinë e rekrutimit të gjeneratës së re prej 107 zyrtarësh doganorë, si investim strategjik në ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme për të ardhmen. "Në thelb, këto rezultate përkthehen në një Doganë më të fortë, për një ekonomi më të drejtë dhe një shoqëri më të sigurt", ka theksuar Llugaliu në mesazhin e tij.

Kosova publikon Strategjinë për Ekonominë Kreative 2026-2035

PRISHTINË, 9 JANAR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka publikuar Strategjinë për Ekonominë Kreative të Kosovës 2026-2035 në platformën për konsultime me publikun.

Kosova bëhet vendi i parë në

Ballkanin Perëndimor që harton një strategji të dedikuar posaçërisht për ekonominë dhe industrinë kreative. "Strategjia synon të shfrytëzojë potencialin e plotë të sektorëve kreativë, të fuqizojë talentin, të




mbështesë sipërmarrjen dhe të forcojë lidhjen ndërmjet kulturës, inovacionit dhe zhvillimit ekonomik", thuhet në njoftim.

Ministria thekson se konsultimi publik është thelbësor për të siguruar që

strategjia t'i reflektojë nevojat reale dhe të formësohet bashkërisht nga institucionet, sektori privat, shoqëria civile dhe profesionistët kreativë. Konsultimi publik është i hapur deri më 20 janar.

A MUND TË BLIHET NJË SHTET?

SHBA-të propozojnë formula juridike të ndërlikuara për të marrë kontrollin e një “aseti strategjik”. Nga ideja e blerjes së ishullit te traktatet, ja çfarë duhet ditur për një aneksim të pamundur



Donald Trump po e provon prej vitesh. Në gusht të vitit 2019, gjatë mandatit të tij të parë, ai donte të “blinte Groenlandën”. Një ide e cilësuar si “absurde” dhe e refuzuar pa ekuivok nga kryeministrja daneze Mette Frederiksen. Gjashtë vjet më vonë, ai këmbëngul, duke ndryshuar strategjinë, por jo objektivin: të sigurojë kontrollin e ishullit “për sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara”.

Sipas asaj që raporton The Economist, Uashingtoni do të dëshironte t'i ofronte Nuuk-ut një COFA – Compact of Free Association (Traktat i Asociimit të Lirë), një marrëveshje që SHBA-të tashmë e kanë në fuqi me disa shtete të vegjël të Paqësorit.

Çfarë përmban traktati që SHBA-të do t'i propozonin Nuuk-ut?

COFA është një marrëveshje ndërkombëtare përmes së cilës Shtetet e Bashkuara rregullojnë marrëdhëniet me një shtet sovran. Në praktikë, Uashingtoni i garanton atij shteti autonomi të plotë për çështjet e brendshme dhe e njeh si të pavarur, por merr përsipër përgjegjësinë për mbrojtjen dhe sigurinë e jashtme, si edhe ofron ndihmë financiare.

Në këmbim, SHBA fitojnë të drejtën të përdorin territorin e atij shteti për qëllime strategjike, për shembull për vendosjen e bazave ushtarake. Ky lloj pakti është nënshkruar me shtete të vegjël ishullorë të Paqësorit, Mikronezinë, Ishujt Marshall dhe Palau, ish-territore nën administrim amerikan pas Luftës së Dytë Botërore, dhe daton nga gjysma e dytë e viteve '80. A është juridikisht e mundur që Nuuk të nënshkruajë një traktat të tillë dhe të kalojë nën kontrollin e SHBA-së?

Sipas të drejtës ndërkombëtare, jo.

“Groenlanda nuk është një shtet sovran, por pjesë e Mbretërisë së Danimarkës”, shpjegon ekspertja e qeverisjes ndërkombëtare Ekaterina Antsygina, nga Universiteti i Hamburgut. “Statusi i Groenlandës brenda Mbretërisë së Danimarkës është i rrënjësor fort në të drejtën ndërkombëtare. Sovraniteti danez mbi ishullin është mbështetur vazhdimisht përmes një ushtrimi paqësor dhe të pandërprerë të autoritetit, përmes pranimi të heshtur nga shtetet e tjera dhe njohjes në forumet ndërkombëtare.” Sipas saj, deklaratat e Presidentit Trump, megjithëse

provokuese, injorojnë themelet solide juridike të sovranitetit danez mbi Groenlandën. Për më tepër, ndonëse ishulli gëzon autonomi të gjerë sipas Ligjit për Vetëqeverisjen të vitit 2009, e drejta e tij për vetëvendosje garanton që çdo hap drejt pavarësisë duhet të jetë një vendim demokratik i popullit groenlandez, një vendim që, për momentin, nuk është marrë.

Me fjalë të tjera: negociimi i drejtpërdrejtë me Nuuk-un për një marrëveshje sigurie që përjashton Kopenhagenin “nuk ka bazë ligjore”.

Pse Stephen Miller gabon kur e përkufizon Groenlandën si “koloni daneze”?

“Të përkufizosh Groenlandën si ‘koloni’ është sot juridikisht e pasaktë dhe politikisht keqorientuese.”

Groenlanda ka fituar: Home Rule në vitin 1979; Self-Government në vitin 2009, me njohjen e qartë të së drejtës për vetëvendosje dhe për zgjedhjen e një pavarësie të mundshme në të ardhmen.

“Të përshkruash Groenlandën si koloni injoron evolucionin kushtetues të ishullit dhe shtrembëron të drejtën ndërkombëtare. Marrëdhënia mes Groenlandës dhe

Danimarkës është sot ajo e një territori autonom brenda një shteti sovran, jo e një zotërimi kolonial.”

Sot Trump mendon për një traktat, por në vitin 2019 donte ta blinte Groenlandën. Një tjetër ide e çuditshme?

“Po, por me disa ‘por’”, shpjegon Geraldine Giraudeau, profesoreshë e së drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Perpignan-it.

E drejta ndërkombëtare nuk e ndalon në mënyrë absolute blerjen e territoreve. Historikisht ka pasur raste të dorëzimit të territoreve kundrejt pagesës (Luiziana nga Franca te SHBA-të në vitin 1803, Alaska nga Rusia në vitin 1867).

Megjithatë, sot një transaksion i tillë do të kërkonte pëlqimin e të gjitha palëve të përfshira. Në rastin e Groenlandës, kjo do të thotë marrëveshja si e Danimarkës, ashtu edhe e vetë Groenlandës, një kusht që qartazi nuk ekziston.

SHBA-të janë tashmë të pranishme ushtarakisht në Groenlandë. Pse atëherë Trump interesohet kaq shumë për ishullin?

Shtetet e Bashkuara kanë tashmë një prani ushtarake në Groenlandë me Pituffik Space Base (ish-Thule), një infrastrukturë strategjike kyçe për paralajmërimin e hershëm raketor, mbrojtjen


kundërraketore dhe mbikëqyrjen hapësinore.

“Për Uashingtonin, Groenlanda është një aset strategjik”, shpjegon Justina Budginaite-Froehly, studiuese pranë Europe Center të Atlantic Council, sepse pozicioni i saj gjeografik “e vendos drejtpërdrejt mbi GIUK Gap”, korridori midis Groenlandës, Islandës dhe Mbretërisë së Bashkuar, thelbësor për monitorimin e nëndetësve ruse, dhe potencialisht kineze, që hyjnë në Atlantik.

Ajo paralajmëron se të ndalesh vetëm te dimensionin juridik nuk mjafton: “Ligjshmëria, e vetme, nuk krijon siguri”. Rreziku i vërtetë nuk është një aneksim formal, por “mundësia e ushtrimit të presionit nga fuqi të jashtme në një zonë strategjike të pambrojtur”.

“Nëse Europa dëshiron të sigurojë që asnjë fuqi e jashtme, as SHBA-të, as Rusia, as Kina, të mos mendojë realisht se mund të ushtrojë presion mbi Groenlandën, atëherë duhet të përqendrohet më pak te protestat dhe më shumë te hapat e saj strategjikë”.

“Groenlanda nuk është në shitje, por as nuk duhet lënë e ekspozuar. Nëse Europa nuk merr përsipër përgjegjësinë për sigurinë e saj në Veri, të tjerë do ta bëjnë këtë në vend të saj, duke ndjekur prioritetet e veta strategjike.” / bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Amir Rrahmani nominohet për “EA Sports FC 26 Team of the Year”

PRISHTINË, 9 JANAR - Kapiteni i Kosovës, Amir Rrahmani, është përfshirë në mesin e 19 mbrojtësve më të mirë të vitit nga nominimet e publikuara për “EA Sports FC 26 Team of the Year”, një çmim prestigjioz që nderon futbollistët më të spikatur të vitit kalendarik. Formacioni më i mirë do të zgjidhet nga votat e publikut, ndërsa futbollistët që marrin më shumë vota do të shpallen më 15

janar. Të gjithë tifozët dhe dashamirësit e futbollit mund ta japin votën e tyre për ta ndihmuar Rrahmanin të bëhet pjesë e 11-shes më të mirë të vitit dhe ta tregojë vlerësimin që meriton për kontributin e tij në fushë. 31-vjeçari ka qenë një nga lojtarët më të rëndësishëm te Napoli, duke shënuar një gol në 16 paraqitje dhe duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në mbrojtjen e skuadrës. Përveç

performancave në klub, Rrahmani ka treguar udhëheqësi të madhe edhe me Kombëtaren e Kosovës, duke konsoliduar vendin e tij si një nga mbrojtësit më të respektuar të futbollit shqiptar. Si mund të votoni? Tifozët mund të hyjnë në faqen zyrtare të “EA Sports FC 26 Team of the Year” dhe t’i zgjedhin futbollistët e pëlqyer nga secili pozicion për ta formuar 11-shen ideale të vitit.



FBK-ja REAGON PAS SULMIT NDAJ DARDAN BERISHËS NË PRIZREN, PARALAJMËRON MASA TË RËNDA NDËSHKUESE PËR BASHKIMIN

PRISHTINË, 9 JANAR - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka dënuar me ashpërsi incidentin gjatë ndeshjes KB Bashkimi - KB Go+ Peja, ku lojtari i ekipit mysafir, Dardan Berisha, është goditur me një shkrepëse dhe ka pasur fyerje të tifozëve, duke cenuar rëndë sportivitetin dhe imazhin e basketbollit të Kosovës. “Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) dënon në mënyrën më të ashpër të mundshme incidentin e rëndë të ndodhur gjatë ndeshjes ndërmjet KB Bashkimi dhe KB Go+ Peja, e zhvilluar mbrëmë në Prizren në kuadër të çerekfinales së Kupës së



Kosovës. Gjatë minutës së tretë të çerekut të dytë, lojtari i KB Go+ Peja, Dardan Berisha, është goditur nga

tribuna me një shkrepëse, një akt i rrezikshëm, i turpshëm dhe absolutisht i papranueshëm në një ngjarje


sportive. Po ashtu, gjatë ndeshjes janë dëgjuar fyerje dhe sharje ndaj ekipit mysafir, të cilat cenojnë rëndë imazhin e basketbollit dhe çdo normë të sportivitetit”, është thënë në reagimin e FBK-së. FBK-ja ka paralajmëruar masa drastike ndaj Bashkimit dhe çdo përsëritjeje të skenave të tilla në palestrat e vendit. “FBK-ja njofton publikun dhe opinionin sportiv se ka hapur menjëherë procedurë disiplinore dhe se organizatori do të përballet me masa të rënda ndëshkuese, sipas akteve normative në fuqi. Toleranca për dhunë, sulme fizike apo sjellje fyese në palestrat tona

është zero. Federata kërkon nga klubet që të marrin përgjegjësinë e plotë për sigurinë në tribunat e tyre dhe paralajmëron se çdo përsëritje e incidenteve të kësaj natyre në të ardhmen do të sjellë masa drastike, përfshirë gjoka të larta, mbyllje palestrash dhe/ose humbje të ndeshjeve me rezultat zyrtar. FBK u bën thirrje të gjithë tifozëve të vërtetë të basketbollit që të mos tolerojnë individë apo grupe që e njollosin sportin tonë. Ata nuk e përfaqësojnë basketbollin kosovar dhe nuk do të lejohen ta shkatërrojnë atmosferën sportive”, është thënë në reagimin e FBK-së.

PSG-ja FITON SUPERKUPËN E FRANCËS, MPOSHT RIVALIN E VJETËR OLIMPIQUE MARSEILLE

PARIS, 9 JANAR - Finalja në mes të Marseilles dhe PSG-së ka dhuruar emocione të forta dhe një spektakël të vërtetë futbollit, duke u mbyllur me barazim 2-2 në kohën e rregullt, përpara se parizienët të triumfonin nga pika e bardhë. PSG e ka nisur më mirë takimin dhe gjeti avantazhin në minutën e 13-t, kur Ousmane Dembele ka realizuar me klasë brenda zonës, duke kaluar topin mbi portierin Rulli për golin e parë të finale. Marseille nuk është dorëzuar

dhe ka rritur presionin në pjesën e dytë, por është përballur disa herë me pritjet vendimtare të portierit Chevalier. Këmbëngulja është shpërblyer në minutën e 74-t, kur pas një ndërhyrjeje të Chevalierit, arbitri ka akorduar penallti, të cilën Mason Greenwood e ka shndërruar në gol për barazimin 1-1. Në minutën e 87-t Marseille ka kaluar në avantazh pas një autogoli të Willian Pachos, i cili ka devijuar gabimisht topin në portën e tij gjatë një harkimi në



zonë. Kur gjithçka dukej se po shkonte drejt fitores së Marseilles, PSG-ja ka reaguar në sekondat e fundit. Në minutën e 90+5', pas një harkimi të Bradley Barcola, Gonçalo Ramos ka realizuar golin e barazimit, duke e çuar finalen në penallti. Nga pika e bardhë, PSG-ja është treguar më e saktë dhe më e ftohtë, duke fituar serinë e penalltive dhe duke ngritur trofeun e Superkupës pas një finaleje dramatike dhe të paharrueshme.


Lewandowski nuk largohet në janar nga Barcelona

BARCELONË, 9 JANAR - Sulmuesi polak i Barcelonës, Robert Lewandowski, nuk e ka ndërmend të largohet nga klubi gjatë janarit, sipas

gazetarit të njohur Fabrizio Romano. Romano ka njoftuar se klubet nga Arabia Saudite janë të interesuara për Lewandowskin dhe e kanë

ndjekur prej vitesh, por transferim i mundshëm konsiderohet vetëm për verë dhe jo për këtë periudhë dimri, pasi Barcelona synon

ta mbajë sulmuesin kryesor deri në përfundim të sezonit për t'i ruajtur stabilitetin në skuadër dhe ambiciet për tituj.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "I D K KONSTRUKSION" SH.P.K. Dega në Kosovë me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811576597 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "I D K KONSTRUKSION" SH.P.K. podružnica na Kosovu, sa sjedistem u Pristini donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811576597 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "I D K KONSTRUKSION" SH.P.K. branch in Kosovo, with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811576597 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "StepArch" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811963306.

- "Red Global" L.L.C. emri Tregtar Yummi Yummi Doner shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 812314772.

- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Pjeter Bogdani" Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit "Krenar Abrashi" B.I. me nr. Unik: 811133719.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greiçevci".

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, salon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

